



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/34/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga F.M ndaj gjyqtarit B.A, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 16.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga F.M ndaj gjyqtarit B.A, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

F.M me datë 13.12.2024 në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit B.A, ankesë kjo e cila është përcjellë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 23.12.2024.

Parashtruesi i ankesës ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit B.A me pretendimet për shkelje disiplinore në lëndën gjyqësore P.nr.2748/21, ku sipas aktakuzës në këtë lëndë po akuzohet M.M, për veprën penale Kanosja nga neni 184 të KPK-së, ku sipas tij me datë 04.04.2024 nga avokati mbrojtës av. A.L është paraqitur kundërshtimi i aktakuzës, por që sipas tij gjyqtari nuk ka vepruar sipas neneve 244,245 të KPP-së duke mos vendosur në lidhje me këtë kundërshtim në afat prej 15 ditësh nga mos marrja e përgjigjes së Prokurorit. Tutje ka deklaruar se në këtë kundërshtim janë bashkangjitur prova të mjaftueshme që pala kallëzuese ka bërë kallëzim të rrejshëm a po lajmërim të rrejshëm, ku këto prova janë dorëzuar që më shumë se 8 muaj në PTHP si dhe në GJTHP, mirëpo prej dorëzimit të këtyre provave deri më tash nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga gjykata se a është intervistuar dikush a po është ri kualifikuar vepra penale a po masat që janë ndërmarrë për këta persona, kjo sepse sipas tij para se rasti të arrij në gjykatë M.M është dërguar në mbajtje 48 orë, edhe pse në mungese të provave. Tutje ka deklaruar se tani M.M i duhen dokumentet për të kaluarën kriminale dhe atë nga policia të cilët nuk po e dorëzojnë asnjë vërtetim në lidhje me këtë çështje, ndërsa nga gjyqtari i rastit nga muaji prill 2024 e deri në nëntor 2024 ka parastruar kërkesa për informata por pa përgjigje.

Sipas tij, gjithë kjo procedurë e ndjekur nga gjyqtari i rastit B.A në GJTHP, nuk mund të jetë konform dispozitave ligjore, duke kërkuar që ndaj gjyqtarit B.A të merren masa disiplinore.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari ka deklaruar se me lëndën në fjalë është ngarkuar me datë 13.10.2023 si me të gjitha lëndët e tjera me pranimin e detyrës si gjyqtar, ku pas disa përpjekjeve të vazhdueshme me datë 08.03.2024 ka arritur që të mbaj seancën fillestare në këtë rast meqë rast i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, e ku më pas të njëjtit sipas nenit 240 par. 7 të KPRK-së gjykata e ka njoftuar në lidhje me të drejtën për kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhje të

aktakuzës. Me datë 04.04.2024 në gjykatë është dorëzuar kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hudhje të aktakuzës, një kërkesë voluminoze, ku gjykata me datë 17.04.2024 i ka përcjellë Prokurorit të Shtetit kërkesën e mbrojtësit për të dhënë përgjigje me shkrim, të cilën kërkesë Prokuroria e ka pranuar me datë 22.04.2024, mirëpo edhe përkundër kësaj, prokurori nuk ka paraqitur përgjigje në afatin prej 15 ditësh që është përcaktuar me dispozita ligjore.

Tutje gjyqtari ka deklaruar se është në dijeni se vendimi lidhur me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhje të aktakuzës është dashur të merret në maj të vitit 2024, por për shkaqe objektive nuk ka pasur mundësi të përpiloj vendimin deri me datë 02.12.2024, i cili vendim konform dispozitave ligjore i është përcjellë palëve në procedurë, e të cilin vendim i pandehuri M.M e ka pranuar me datë 11.12.2024, e po ashtu edhe mbrojtësi i tij av. A.L.

Gjyqtari ka deklaruar se si çdo lëndë tjetër edhe kjo lëndë është trajtuar nga ana e tij me seriozitet dhe përkushtim profesional dhe lënda asnjëherë nuk është neglizhuar nga gjyqtari për trajtim, mirëpo kushtet objektive kanë pamundësuar që të përpilohet vendimi në kohë. Kjo sepse është i ngarkuar me një numër të madh të lëndëve dhe deri në muajin nëntor të vitit 2024 ka funksionuar pa staf mbështetës, ku për të gjitha këto pengesa e ka njoftuar me kohë Kryetaren e Gjykatës.

Në fund ka deklaruar se pretendimi se i pandehuri M.M padrejtësisht është akuzuar, janë çështje që gjykata do ti vlerësoj në shqyrtim gjyqësor, pasi që si gjykatë nuk ka autorizim të vlerësoj gjendjen faktike në këtë fazë të procedurës, por në shqyrtim gjyqësor dhe në prezencë të të gjitha palëve do të vërtetohet drejtë edhe gjendja faktike, e për të cilat gjykata ka dhënë arsye në aktvendimin ndaj të cilit mbrojtësi i të pandehurit av. A.L ka paraqitur ankesë dhe tanimë lënda gjendet në Gjykatën e Apelit për vendosje.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.A.

Në lidhje me pretendimin e parashtruar nga ankuesi se gjyqtari i çështjes nga muaji prill 2024 nuk ka trajtuar kërkesën e të njëjtit për kundërshtim të provave dhe hudhje të aktakuzës në lëndën P.nr.2748/21, njoftojmë parashtruesin se gjyqtari i çështjes B.A është i ngarkuar me rreth 700 lëndë gjyqësore të natyrës penale dhe rreth 100 lëndë të natyrës kundërvajtëse, ku përveç kësaj i shtojmë faktin se ndër këto lëndë ka lëndë që i takojnë grupit të lëndëve që ligji ju jep prioritet e që janë lëndët me paraburgim a po lëndët e dhunës në familje, ku gjyqtarët janë të obliguar të veprojnë me urgjencë dhe prioritet.

Numri i madh i lëndëve që trajtohen nga gjyqtarët shpesh rezulton në pamundësinë për tu përmbajtur afateve ideale për çdo lëndë, ku nga statistikat shohim se gjyqtarët janë të ngarkuar me më shumë lëndë se sa është praktikisht e mundur që të trajtohen brenda një kohe të shkurtër. Përveç kësaj, për tu siguruar që çdo vendim i marrë është i drejtë dhe i paanshëm, kërkohet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e detajuar të provave dhe materialeve të paraqitura në secilin rast.

Gjithashtu, duhet theksuar edhe faktin se sistemi gjyqësor aktualisht po përballet me një mungesë të burimeve njerëzore dhe teknike, gjë që ndikon në kohëzgjatjen e trajtimit të lëndëve. Kjo situatë është e njohur dhe adresimi i saj është objekt i planeve dhe reformave brenda sistemit gjyqësor.

Gjyqtari i çështjes në vazhdimësi ka njoftuar Kryetaren e Gjykatës në lidhje me ngarkesën me lëndë në raport me faktin se ka qenë pa staf mbështetës deri në nëntor të vitit 2024, andaj Kryetarja e Gjykatës ka gjetur se deri te vonesa në trajtimin e kësaj kërkesë nga ana e gjyqtarit ka ardhur si pasojë e kësaj e jo për shkak se gjyqtari me veprimet apo mosveprimet e tij ka ndikuar qëllimshëm në mos trajtimin e kërkesës. Mos trajtimi i kësaj kërkesë ka ndodhur për shkak të faktorit objektiv, siç është numrit i madh i lëndëve të cilat i ka pranuar gjyqtari në këtë periudhë dhe mungesa e stafit mbështetës që në Gjykatën Themelore në Prishtinë është fakt notor dhe tashmë i ditur.

Pretendimi i ngritur nga parashtruesi i ankesës se nuk është njoftuar se a është intervistuar dikush a po a është marrë masa ndaj personave që sipas tij në atë kërkesë ka bashkangjitur prova për të njëjtit, njoftojmë parashtruesin e kërkesës se këto pretendime nuk mund të shqyrtohen në këtë fazë të procedurës pasi që legjislacioni në fuqi ka paraparë se të gjitha faktet dhe provat në dëm a po në dobi të të akuzuarit shqyrtohen gjatë procedurës së të provuarit në shqyrtim gjyqësor.

Ndërsa, po ashtu në asnjë fazë të procedurës gjyqësore nuk mund të merret në pyetje një person a po të shqyrtohet ndonjë provë në lidhje me rastin a po të bëhet rikualifikim i veprës penale pa prezencën e të gjitha palëve në procedurë.

Sa i përket faktit se për shkak të mos trajtimit të kësaj lënde i pandehuri nuk po ka mundësi që të nxjerrë vërtetim mbi të kaluarën kriminale në Policinë e Kosovës, ju njoftojmë se nga data 01.11.2024 Policia e Kosovës nuk lëshon vërtetimet mbi të kaluarën kriminale kjo referuar Ligjit mbi Sistemin Qendror të Evidencës Penale, i cili ka shfuqizuar çdo dispozitë tjetër ligjore që përcakton nxjerrjen apo lëshimin e certifikatave që ndërliken me evidencën penale nga Policia e Kosovës. Sipas këtij ligji, Departamenti i Evidencës Qendrore Penale pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbetet përgjegjës për t'i lëshuar këto vërtetime, prandaj palët kërkuese/zyrtarët mund të aplikojnë në gjykatat që mbulojnë territorin e tyre.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/34/24, me datë 15.01.2025

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë